

VENDIM
Nr. 438, datë 22.5.2013

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI DHE
SISTEMIMI I RRUGËS “JERONIM DE RADA”, BLLOKU TE SHKOLLA “MARIGO POZIU”,
LAGJEVE “RILINDJA”, “LEF SALLATA”, “1 MAJI” DHE “24 MAJI”
NË BASHKINË E VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5/1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni dhe sistemimi i rrugës “Jeronim de Rada”, blloku te shkolla “Marigo Poziu”, lagjeve “Rilindja”, “Lef Sallata”, “1 Maji” dhe “24 Maji” në bashkinë e Vlorës.

2. Pasuritë, në sipërfaqen prej 737.84 (shtatëqind e tridhjetë e shtatë pikë tetëdhjetë e katër) m² truall dhe 236.25 (dyqind e tridhjetë e gjashtë pikë njëzet e pesë) m² objekt, pronë private, që shpronësohen, si dhe pronarët që shpronësohen janë sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, e cila është pjesë përbërëse e tij.

3. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve shpronësohen, është 17 965 060 (shtatëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëdhjetë) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Vlorës, planifikuar në buxhetin e saj.

4. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Vlorës.

6. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Vlorës për realizimin e këtij projekti.

7. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë së Vlorës. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 737.84 (shtatëqind e tridhjetë e shtatë pikë tetëdhjetë e katër) m² truall dhe 236.25 (dyqind e tridhjetë e gjashtë pikë njëzet e pesë) m² objekt, shpronësuar në favor të bashkisë së Vlorës, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Ngarkohen bashkia e Vlorës dhe Ministria e Brendshme për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR
RIKONSTRUKSIONIN DHE SISTEMIMIN E RRUGËVE DHE BLOQEVË TË BANIMIT NË QYTETIN E VLORËS**

Nr.	Emrat e Pronareve	Sip. Truallit m ²	Çmimi per m ²	Vlera e truallit	Sip. Objekti m ²	Çmimi m ²	Vlera e objektit	Vlera Totale	Nr. i pasurise
1	Leonard Andrea	13	29841.97	387945.61	0	0	0	387945.61	27/105
2	Dalip Shabani	0	0	0	23	51594	1186662	1186662	24/74
3	Astrit Mullai	0	0	0	22	51594	1135068	1135068	27/73
4	Astrit Musta	0	0	0	43	V. Gjykate	1200000	1200000	20/156-ND
5	Viron Merkuri	49	29841.97	1462257	11.25	51594	580433	2042689	17/10
6	Zyke Petani	7	29841.97	208893.8	0	0	0	208893.8	12/88
7	Familja Arapi	150	29841.97	4476296	0	0	0	4476296	17/45
8	Llambro Merkuri	54.84	29841.97	1636534	0	0	0	1636534	17/79
9	Dhimitraq Janka	27	29841.97	805733.2	0	0	0	805733.2	17/78
10	Sokrat Malaj	0	0	0	52	25113	1305876	1305876	15/115
11	Agron Toska	8	1902	15216	12	25113	301356	316572	7/138
12	Maliq Nuhu	56	1902	106512	33	25113	828729	935241	16/38
13	Petro Zani	0	0	0	40	25113	1004520	1004520	17/3
14	Vasillaq Dhamo	120	3547	425640	0	0	0	425640	27/148
15	Altin e Maritë	49	3547	173803	0	0	0	173803	7/51
16	Prenci	165	3547	585255	0	0	0	585255	19/78
17	Agim Varfi	39	3547	138333	0	0	0	138333	28/53
	Sofie Dhrami								
	Shuma Totale	737.84	197043.8	10422416	236.25		7542644	17965060	